

**RREGULLORE NR. 2006/10**

**MBI ZGJIDHJEN E ANKESAVE LIDHUR ME PRONËN E  
PALUAJTSHME PRIVATE, DUKE PËRFSHIRË PRONËN BUJQËSORE  
DHE ATË KOMERCIALE**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në përputhje me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Duke marrë parasysh Rregulloren e ndryshuar nr. 1999/1 të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) të datës 25 korrik të vitit 1999 mbi autorizimin e Administratës së Përkohshme në Kosovë,

Me qëllim të arritjes së zgjidhjes së efektshme dhe të shpejtë të ankesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale,

Me anë të kësaj shpall si në vijim:

**Kapitulli I**  
**Agjencia Kosovare e Pronës**

Neni 1  
Themelimi i Agjencisë Kosovare të Pronës

Agjencia Kosovare e Pronës themelohet si agjenci administrative e cila do të funksionojë si organ i pavarur, në pajtim me Kapitullin 11.2 të Kornizës Kushtetuese. Vendimet mbi konstatimet dhe konkludimet e Agjencisë Kosovare mbi Pronën do të merren sipas autorizimit të gjykatave të Kosovës.

Neni 2  
Përgjegjësitë e Agjencisë Kosovare të Pronës

2.1 Agjencia Kosovare e Pronës ka kompetenca për të pranuar, për të regjistruar dhe për të ndihmuar gjykatat në zgjidhjen e kategorive vijuese të ankesave që janë të lidhura me konfliktin, si pasojë e konfliktit të armatosur që ndodhi në periudhën ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999, si:

- (a) Ankesat e pronësisë lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale dhe
- (b) Ankesat lidhur me të drejtat mbi shfrytëzimin e pronës lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale,

ku paditësi aktualisht nuk është në gjendje të ushtrojë të drejtat e tilla pronësore.

2.2 Asgjë në këtë nen nuk i cenon të drejtat e paditësve që të ushtrojnë ankesa pranë gjykatave kompetente që nuk përfshihen në ankesat e paraqitura në nenin 2.1.

**Kapitulli II**  
**Agjencia Kosovare e Pronës**

Neni 3  
Organizimi i Agjencisë kosovare të pronës

Agjencia Kosovare e Pronës përbëhet nga Bordi mbikëqyrës, nga Sekretaria ekzekutive dhe nga Komisioni për ankesa pronësore (Komisioni).

Neni 4  
Bordi mbikëqyrës i Agjencisë Kosovare të Pronës

4.1 Një Bord mbikëqyrës do të mbikëqyrë punën e Agjencisë Kosovare të Pronës dhe do të ofrojë mbikëqyrje administrative e udhëzime për politikat dhe orientimin e përgjithshëm. Nuk do të marrë pjesë në procesin përmes të cilit Komisioni i miraton konstatimet dhe konkludimet për ankesat individuale.

4.2 Bordi mbikëqyrës përbëhet prej pesë (5) anëtarëve. Pas një muaji nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm i emëron pesë anëtarët e Bordit mbikëqyrës, dy prej të cilëve do të emërohen nga Kryeministri. Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm do të caktojë për kryesues njërin prej tre (3) anëtarëve të Bordit mbikëqyrës i cili nuk është emëruar nga Kryeministri.

4.3 Nëse Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm konstaton se do të jetë e duhur, gjashtë (6) muaj pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje ai cakton edhe dy (2) anëtarë të tjerë në Bordin mbikëqyrës me emërimin e Kryeministrit, të cilët i zëvendësojnë dy anëtarët tjerë përveç kryesuesit i cili nuk është emëruar nga Kryeministri.

4.4 Anëtarët e Bordit mbikëqyrës shërbejnë për një mandat njëvjeçar, i cili mund të ripërtëritet.

4.5 Asnjë person nuk mund të bëhet apo të mbetet anëtar i Bordit mbikëqyrës nëse:

(a) Është dënuar me burgim prej një apo më shumë vitesh pas një procesi të duhur dhe në pajtim me standardet ndërkombëtare;

(b) Është përjashtuar apo larguar për keqsjellje profesionale nga ushtrimi i profesionit të tij ose

(c) Ka interesa që janë në konflikt me përgjegjësitë e tij sipas kësaj Rregulloreje.

4.6 Anëtari i Bordit mbikëqyrës mund të largohet prej kësaj detyre nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm nëse:

(a) E humb të drejtën për të shërbyer si anëtarë i Bordit mbikëqyrës sipas nenit 4.5;

(b) E përdor postin e tij në mënyrën e cila nuk është në pajtim me detyrat dhe përgjegjësitë e tij zyrtare të përcaktuara me këtë Rregullore ose

(c) Shpërfill jashtë mase detyrat e tij sipas kësaj Rregulloreje.

Neni 5  
Sekretaria ekzekutive

5.1 Sekretaria ekzekutive e ka drejtorin dhe zëvendësdrejtorin, të cilët caktohen nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm. Zëvendësdrejtori emërohet nga Kryeministri.

5.2 Përgjegjësitë e Sekretarisë ekzekutive përfshijnë regjistrimin e ankesave dhe përgjigjet në ankesat e tilla si dhe njoftimin e palëve dhe përgatitjen e ankesave e përgjegjeve në ankesa për t'u shqyrtuar nga Komisioni. Detyrat dhe përgjegjësitë e Sekretarisë ekzekutive mund të paraqiten në detaje në një urdhëresë administrative të nxjerrë nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

Neni 6  
Komisioni për ankesa pronësore

6.1 Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm i emëron anëtarët e Komisionit dhe një anëtar e cakton për kryesues. Anëtarët e Komisionit janë ekspertë në lëmin e të drejtës pronësore-banesore dhe të aftë për të ushtruar kompetenca gjyqësore në postin e tyre.

6.2 Komisioni përbëhet nga dy (2) anëtarë ndërkombëtarë dhe një vendor. Anëtari vendor emërohet nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm me caktimin e kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës.

6.3 Nëse Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm e konsideron të duhur, gjashtë (6) muaj pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje ai mund të emërojë edhe një anëtar tjetër vendor të Komisionit i cili e zëvendëson anëtarin ndërkombëtar që nuk është kryesues.

Neni 7  
Emërimi dhe shkarkimi nga detyra i anëtarëve të Komisionit të ankesave pronësore

7.1 Anëtarët e Komisionit emërohen nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm për një mandat fillestar njëvjeçar dhe mund të riemërohen për një apo më tepër afate.

7.2 Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mund ta largojë anëtarin e Komisionit nga detyra me rekomandim të shumicës së anëtarëve të Komisionit për

shkak të mungesës së kualifikimit përkatës për atë post ose për shkak të mospërbushjes së vazhdueshme dhe të paarsyetuara të detyrave të postit.

## Neni 8 Parashtrimi i ankesave

8.1 Personi mund të parashtojë ankesë të paraparë në nenin 2.1 në Sekretarinë ekzekutive.

8.2 Pas marrjes së ankesës Sekretaria ekzekutive ia dërgon një kopje gjykatës kompetente.

8.3 Sekretaria ekzekutive i pranon ankesat në zyrat e themeluara për këtë qëllim në Kosovë nga data e hyrjes së kësaj Rregulloreje në fuqi.

8.4 Sekretaria ekzekutive do të vendosë një procedurë për të lehtësuar pranimin e ankesave nga personat e zhvendosur brenda vendit ku aktualisht banojnë jashtë Kosovës.

## Neni 9 Procedura për përpunimin e ankesave

9.1 Pas pranimit të ankesës, Sekretaria ekzekutive e njofton dhe i dërgon nga një kopje të ankesës çdo personi, përpos paditësit, i cili aktualisht ushtron apo pretendon se ka të drejtë në pronën e cila është objekt i ankesës dhe bën përpjekje të arsyeshme për të njoftuar çdo person tjetër i cili mund të ketë ndonjë interes ligjor në këtë pronë. Në rastet e duhura, përpjekjet e tilla të arsyeshme do të jenë në formë të një lajmërimi në një botim zyrtar të Sekretarisë ekzekutive.

9.2 Çdo person, përveç paditësit, i cili aktualisht ushtron ose pretendon se ka të drejtë në pronën e cila është objekt i ankesës ose çdo person tjetër i cili mund të ketë ndonjë interes ligjor në pronën ndaj së cilës është parashtruar ankesë është palë në këtë ankesë, me kusht që personi i tillë të informojë Sekretarinë ekzekutive për qëllimin e tij që të marrë pjesë në procedurën administrative brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi për ankesën nga Sekretaria ekzekutive, në pajtim me nenin 9.1.

9.3 Personi me interes ligjor në ankesë, i cili nuk ka marrë njoftimin mbi ankesën mund të pranohet si palë kurdoqoftë gjatë procedurës.

9.4 Brenda tridhjetë (30) ditëve nga marrja e kopjes së ankesës, pala pranuese mund t'i dërgojë Sekretarisë ekzekutive përgjigje në ankesë.

#### Neni 10

#### Konkludimet e Komisionit të ankesave pronësore

10.1 Komisioni arrin tek konstatimet dhe konkludimet në bazë të ankesës dhe përgjigjes apo përgjigjeve.

10.2 Kur është në interes të drejtësisë, Komisioni mund të kërkojë dhe të shqyrtojë edhe parashtrës të tjera nga palët apo të mbajë seancë dëgjimore të të gjitha palëve të përfshira, duke përfshirë edhe dëshmitarët dhe ekspertët. Në rastet e tilla Komisioni vepron me shpejtësi.

10.3 Agjencia Kosovare e Pronës ia dërgon konkludimet e Komisionit gjykatës kompetente, kurse palëve u dëgon kopje të tyre.

### **Kapitulli III**

### **Kompetenca e gjykatave**

#### Neni 11

#### Dispozitat e përgjithshme

Procedurat e zbatuara pranë Agjencisë Kosovare të Pronës dhe konkludimet e nxjerra nga Komisioni nuk e cenojnë pushtetin suprem të gjykatave me kompetencë territoriale dhe lëndore lidhur me ankesat nga neni 2.1 për zgjidhjen e këtyre ankesave.

#### Neni 12

#### Vendimet e gjykatave kompetente

12.1 Asnjë gjykatë në Kosovë nuk ushtron kompetencë për ankesat me kompetencë lëndore nga neni 2.1 përveç nëse ankesa e tillë i është dërguar asaj nga Agjencia Kosovare e Pronës në të cilën janë bashkëngjitur konkludimet në pajtim me nenin 10.

12.2 Katërdhjetë e pesë (45) ditë pas marrjes së konkludimeve të nxjerra nga Komisioni lidhur me ndonjë ankesë, gjykata kompetente ua dërgon vendimin

palëve dhe Agjencisë Kosovare të Pronës. Përmes vendimit të tillë gjykata kompetente:

- (a) Vërteton konkludimet e Komisionit;
- (b) Refuzon konkludimet e Komisionit;
- (c) Kërkon nga Komisioni sqarim që mund të jetë në formë të pyetjes apo pyetjeve lidhur me bazën për konkluzat e Komisionit për të lehtësuar marrjen e vendimit lidhur me ankesën ose
- (d) Urdhëron Komisionin dhe/ose Sekretarinë ekzekutive mbi zbatimin adekuat të ligjit dhe/ose të dispozitës dhe vlerësimin e provave e argumenteve shtesë dhe/ose mbi ekzaminimet a vlerësimet tjera.

12.3 Nëse pas marrjes së sqarimit nga Komisioni të kërkuar sipas paragrafit 2(c) apo të konkluzave të reviduara të Komisionit pas urdhërimit sipas paragrafit 2(d), gjykata kompetente konstaton se akoma është e pakënaqur, ajo vetë mund të marrë vendim duke marrë parasysh bazueshmërinë e ankesës.

12.4 Nëse gjykata kompetente kërkon sqarim ose nxjerr urdhëresë sipas paragrafit 2, Komisioni dhe/ose Sekretaria ekzekutive ia dorëzon sqarimin gjykatës kompetente dhe palëve apo e ekzekuton urdhëresën brenda tridhjetë (30) ditëve nga marrja e kërkesës për sqarim a e urdhëresës.

12.5 Kur pas kërkesës për sqarim ose nxjerrjes së urdhëresës nga paragrafi 2(c) ose 2(d) lart ka vonesë të paarsyeshme, paditësi mund t'i propozojë Gjykatës Supreme nxjerrjen e urdhrit për ndërmarrjen e veprimeve të menjëhershme. Gjykata Supreme vendos mbi propozimin e tillë brenda dhjetë (10) ditësh nga dorëzimi i propozimit. Nëse Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se ka pasur vonesë të paarsyeshme, ajo e urdhëron gjykatën kompetente që të nxjerrë vendim brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i urdhrit të tillë. Nëse gjykata kompetente nuk nxjerr vendim brenda tridhjetë (30) ditëve të lartpërmendura, Gjykata Supreme brenda dhjetë (10) ditësh nxjerrë vendim mbi ankesën, duke marrë parasysh konkluzat e nxjerra nga Komisioni. Nëse Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se nuk ka pasur vonesë të paarsyeshme, ajo e njofton gjykatën kompetente e palët dhe gjykata mbetet përgjegjëse për shqyrtimin e ankesës dhe vazhdon me procedurën.

12.6 Gjykata kompetente mund të nxjerrë vendim për refuzimin e konkluzave të Komisionit me arsyetim se:

- (a) Konkluzat përmbajnë ndonjë shkelje materiale të ligjit në fuqi ose
- (b) Konkluzat bazohen në fakte jo të plota apo në vlerësimin e gabuar të fakteve.

12.7 Pa cenuar paragrafët 4 dhe 5, nëse gjykata kompetente nuk merr vendim sipas paragrafit 2 pas skadimit të dyzet e pesë (45) ditëve nga data e marrjes së konkluzave të Komisionit në lidhje me ndonjë kërkesë, Agjencia Kosovare e Pronës i dërgon palëve dhe gjykatës kompetente njoftimin se brenda shtatë (7) ditëve pas marrjes së njoftimit palët mund t'i parashtrojnë kërkesë Gjykatës Supreme me të cilën kërkohet që të urdhërohet gjykata kompetente që të merr vendimin sipas paragrafit 2. Nëse brenda kësaj periudhe prej shtatë ditëve asnjëra palë nuk paraqet kërkesë në Gjykatën Supreme, konkluzat e Komisionit bëhen të plotfuqishme dhe të zbatueshme si vendim përfundimtar pa cenuar të drejtën e ankesës në bazë të nenint 13. Agjencia Kosovare e Pronës i udhëzon me kohë dhe në mënyrën e duhur palët.

12.8 Nëse ndonjë palë paraqet kërkesë në Gjykatën Supreme për ta urdhëruar gjykatën kompetente që të merr vendimin sipas paragrafit 2, kjo palë në të njëjtën kohë ia dërgon këtë kërkesë edhe Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut, Agjencisë Kosovare të Pronës, gjykatës kompetente dhe palës ose palëve tjera.

12.9 Pas marrjes së kërkesës drejtuar Gjykatës Supreme për ta urdhëruar gjykatën kompetente që të merr vendimin sipas paragrafit 2, Departamenti i Drejtësisë brenda një kohe të shkurtë ia paraqet Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm një kërkesë për caktimin e trupit gjykues prej tre (3) anëtarëve në Gjykatën Supreme, ku përfshihen së paku dy gjykatës ndërkombëtarë, prej të cilëve njëri do të jetë kryetar i trupit gjykues, i cili do të vendos lidhur me kërkesën.

12.10 Gjikata Supreme vendos lidhur me kërkesën brenda shtatë (7) ditëve pas caktimit të trupit gjykues prej tre (3) anëtarëve nga Departamenti i Drejtësisë. Ky vendim i dërgohet gjykatës kompetente, palëve dhe Agjencisë Kosovare të Pronës. Brenda shtatë (7) ditëve pas marrjes së vendimit të Gjykatës Supreme, gjykata kompetente e merr vendimin sipas paragrafit 2 në përputhje me vendimin e Gjykatës Supreme. Vendimi i gjykatës kompetente i dërgohet Gjykatës Supreme, Agjencisë Kosovare të Pronës dhe palëve. Në rast se gjykata kompetente nuk merr vendim brenda periudhës prej shtatë ditëve, konkluzat e Komisionit bëhen të plotëfuqishme dhe të zbatueshme si vendim përfundimtar pa cenuar të drejtën e ankesës në bazë të nenint 13. Agjencia Kosovare e Pronës i udhëzon me kohë dhe në mënyrën e duhur palët.



Neni 13  
Ankesat

13.1 Brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve prej marrjes së vendimit të gjykatës kompetente me të cilin vërtetohen ose hudhen poshtë konkluzat e Komisionit, ose brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve kur palët janë njoftuar se konkluzat e Komisionit janë bërë të plotfuqishme dhe të zbatueshme si vendim përfundimtar, ndonjëra palë mund t'i paraqesë Gjykatës Supreme të Kosovës ankesë kundër këtij vendimi për arsye se:

- (a) Vendimi përmban ndonjë shkelje të rëndë të ligjit në fuqi ose
- (b) Vendimi bazohet në fakte jo të plota apo në vlerësimin e gabuar të fakteve.

13.2 Në të njëjtën kohë kur pala ia paraqet ankesën Gjykatës Supreme, ajo ia paraqet kopjet e kësaj ankese edhe Agjencisë Kosovare të Pronës. Pas marrjes së ankesës, Gjykata Supreme ia dërgon kopjet palës ose palëve të tjera dhe gjykatës kompetente.

13.3 Nëse kërkohet, Sekretaria ekzekutive e Agjencisë Kosovare të Pronës i siguron palës së pakënaqur informatat dhe udhëzimet lidhur me procedurën që duhet ndjekur për përgatitjen e ankesës për Gjykatën Supreme të Kosovës.

13.4 Brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve prej marrjes së kopjes së ankesës, pala ose palët tjera ia paraqesin përgjegjen me shkrim kërkuesit dhe një kopje Gjykatës Supreme të Kosovës.

13.5 Gjykata Supreme e Kosovës vendos lidhur me ankesat në trupin gjykues prej tre anëtarëve, prej të cilëve dy janë gjykatës ndërkombëtarë dhe njëri gjykatës është banor i Kosovës.

13.6 Nëse është në interes të drejtësisë, pas marrjes së përgjegjes nga ndonjë palë përveç palës kërkuese, Gjykata Supreme e Kosovës mund të kërkojë dhe të shqyrtojë parashtrësia të tjera me shkrim të palëve ose të mbajë seancë dëgjimore verbale. Në këto raste Gjykata Supreme e Kosovës vepron në mënyrë të shpejtë.

13.7 Brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve prej datës kur Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se i ka marrë të gjitha dëshmitë që i nevojiten për të vendosur lidhur me ankesën, ajo merr vendim lidhur me ankesën të cilin ia dërgon gjykatës kompetente, Agjencisë Kosovare të Pronës dhe palëve.

13.8 Me vendimet e veta, Gjykata Supreme e miraton ose e refuzon ankesën.

#### Neni 14

#### Ligji në fuqi për kontestet civile

Përveç nëse përcaktohet ndryshe me anë të kësaj Rregulloreje ose ndonjë Urdhërese Administrative të mëvonshme të nxjerrë për zbatimin e saj në pajtim me nenin 22 të kësaj Rregulloreje, procedurat gjyqësore për kontestet civile në bazë të kësaj Rregulloreje do të drejtohen në bazë të ligjit në fuqi. Afatet kohore të përcaktuara në këtë Rregullore gjithmonë kanë përparësi në rast të ndonjë dispozite kundërthënëse të ligjit në fuqi për kontestet civile.

### **Kapitulli IV**

#### **Ekzekutimi i vendimeve**

#### Neni 15

#### Ekzekutimi i vendimeve

15.1 Vendimi i gjykatës kompetente, respektivisht i Gjykatës Supreme ose ndonjë vendim i cili merr formën e prerë dhe të plotfuqishme sipas kësaj Rregulloreje, hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas datës kur vendimi bëhet i formës së prerë e i plotfuqishëm dhe i dërgohet ose njoftohen për të palët dhe Agjencia Kosovare e Pronës.

15.2 Mjetet ligjore për zbatimin e vendimit mund të përfshijnë dëbimin, vënien e pronës nën administrim, ndonjë marrëveshje për dhënien me qira, konfiskimin e ndërtesave të kundërligjshme, shitjen me aukcion ose kompenzimin.

15.3 Në rast se vendimi ka të bëjë me dëbimin e personave, Agjencia Kosovare e Pronës ia dërgon vendimin me të cilin vërtetohet urdhri për dëbimin e poseduesit aktual të pronës kontestuese.

15.4 Vendimi me të cilin vërtetohet urdhri për dëbim bëhet i zbatueshëm pas dorëzimit të tij. Urdhri për dëbim mund të zbatohet kundër çdo personi që ndodhet në atë pronë në kohën e dëbimit.

15.5 Dëbimi zbatohet nga nëpunësi përgjegjës i Agjencisë Kosovare të Pronës me ndihmën e organeve për zbatimin e rendit dhe ligjit. Ky nëpunës dhe organet duhet ta kenë fleturdhëresën e nënshkruar nga drejtori i Agjencisë Kosovare të Pronës.

15.6 Gjatë zbatimit të urdhrin për dëbim, ndonjë person i cili nuk i përmbahet udhëzimeve të nëpunësit përgjegjës për t'u larguar nga prona mund të largohet nga organet për zbatimin e rendit dhe ligjit. Në rast se në lidhje me urdhrin për dëbim largohet pasuria e luajtshme, Agjencia Kosovare e Pronës duhet të bëjë përpjekje të arsyeshme për të minimalizuar rrezikun e dëmtimit apo të humbjes së kësaj pasurie.

15.7 Agjencia Kosovar e Pronës e njofton kërkuesin dhe personin i cili e posedon pronën lidhur me datën e caktuar për dëbim. Pas zbatimit të urdhrin për dëbim, nëse kërkuesi nuk është i pranishëm për ta marrë pronën në posedim të menjëhershëm, nëpunësi përgjegjës e siguron pronën dhe e njofton kërkuesin. Çdo person, i cili pa arsye ligjore hyn në pronën e plumbosur duke e thyer atë, mund t'i nënshtrohet largimit nga prona nga organet për zbatimin e rendit dhe ligjit.

## **Kapitulli V** **Dispozitat kalimtare**

### Neni 16 Prona e braktisur

Agjencia Kosovare e Pronës i merr përsipër përgjegjësitë e Drejtorisë për Çështje Banesore e Pronësore në bazë të nenit 1.1(b) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/23 të datës 15 nëntor 1999 për themelimin e Drejtorisë për Çështje Banesore e Pronësore dhe të Komisionit për ankesa të Drejtorisë Banesore e Pronësore dhe të nenit 12 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/60 të datës 31 tetor 2000 për kërkesat pronësore dhe banesore dhe rregullat e procedurës dhe të provave. Sipas këtij neni, “prona e braktisur” do të interpretohet në përputhje me dispozitat e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/60.

### Neni 17 Pasuria fizike e Drejtorisë për Çështje Banesore e Pronësore

Pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, e drejta e titullarit të të gjitha pasurive fizike, për të cilat kjo e drejtë i është dhënë Drejtorisë për Çështje Banesore e Pronësore, do t'i jepet Agjencisë Kosovare të Pronës.

Neni 18Kontratat e karakterit të së drejtës private

Pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, të drejtat dhe obligimet e Drejtorisë për Çështje Banesore e Pronësore në bazë të të gjitha kontratave të karakterit të së drejtës private në të cilat Drejtoria për Çështje Banesore e Pronësore është palë nënshkruese do të kalojnë te Agjencia Kosovare e Pronës.

Neni 19Kërkesat e parashtruara në Drejtorinë për Çështje Banesore e Pronësore

Agjencia Kosovare e Pronës ka kompetenca ekzekutive përkitazi me ndonjë vendim ose urdhër për dëbim nga Komisioni për ankesa i Drejtorisë për Çështje Banesore e Pronësore të cilat kanë mund, por nuk janë zbatuar deri në datën e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje nga ana e Drejtorisë për Çështje Banesore e Pronësore. Gjatë ushtrimit të këtyre kompetencave ekzekutive, Agjencia Kosovare e Pronës i ka të drejtat, obligimet, përgjegjësitë dhe kompetencat të cilat para hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje i ka pasur Drejtoria për Çështje Banesore e Pronësore.

Neni 20Ankesat e parashtruara në gjykata

Dispozitat e kësaj Rregulloreje zbatohen për çdo ankesë nga neni 2.1 të cilat i janë paraqitur gjykatës kompetent, me kusht që procedurat gjyqësore në lidhje me atë ankesë të mos kenë filluar para datës së hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje.

**Kapitulli VI****Dispozitat përfundimtare**Neni 21Ligji në fuqi

Kjo Rregullore shfuqizon çdo dispozitë të ligjit në fuqi që nuk është në përëputhje me të.

Neni 22Zbatimi

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mund të nxjerrë urdhëresa administrative për zbatimin e kësaj Rregulloreje.

Neni 23  
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 4 mars 2006, pa e cenuar pushtetin e vazhdueshëm të Komisionit për ankesa të Çështjeve Banesore e Pronësore për të vendosur lidhur me ankesat të cilat tashmë janë parashtruar dhe paraqitur për rishqyrtimin e vendimeve të tij në përputhje me ligjin në fuqi dhe me Drejtorinë për Çështje Banesore e Pronësore, dhe për të vepruar lidhur me kërkesat për rishqyrtimin e vendimeve në përputhje me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/60. Kjo Rregullore mbetet në fuqi për një periudhë prej dymbëdhjetë (12) muajve. Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mund ta vazhdojë vlefshmërinë e saj edhe për një periudhë tjetër.

Søren Jessen-Petersen  
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm